



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 20 Prot.

Gjirokastrë, më 07 . 01 .2022

V E N D I M

Nr. 01 , datë 07 . 01 . 2022

**PËR DETAJIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2022 PËR ZËRAT PAGAT,
SIGURIMET SHOQËRORE DHE BURSAT E STUDENTËVE**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutit të Universitetit neni 19/f; Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; Ligjit Nr.115/2021 "Për Buxhetin e Vitit 2022"; Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" të ndryshuar; Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej" në mbledhjen e tij të datës 07.01.2022,

V E N D O S I

1. Të miratoj fondin e pagave për stafin akademik dhe personelin mbështetës në shumën **141.461.255** lekë.
2. Të miratoj fondine sigurimeve shoqërore në shumën **28.650.000** lekë.
3. Të miratoj fondin për bursat e studentëve në shumën **12.240.000** lekë.
4. Një kopje e vendimit i përcillet Bordit të Administrimit.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK


Prof.dr.Bektash MEMA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
SENATI AKADEMIK**

Nr. 28 Prot

Datë 07/01/2022

VENDIM

Nr. 02, datë 07.01. 2021

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES SË BULETINIT SHKENCOR "KËRKIME
UNIVERSITARE**

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 38 pika 3; Statutin e "Universitetit "Eqrem Çabej" neni 19 pika 3/d; Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 07.01.2022, pasi diskutoi draftin: "Rregullorja për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokaster",

V E N D O S I

1. Të miratojë Rregulloren për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokaster, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bektash MEHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 177 Prot.

Gjirokastrë, më 11.02.2022

V E N D I M

Nr. 03 , datë 11.02.2022

**MIRATIMI I KRITEREVE TË PRANIMIT PËR STUDENTËT E CIKLIT TË PARË
"BACHELOR " DHE CIKLIT TË DYTË "MASTER I SHKENCAVE " PËR VITIN
AKADEMIK 2023 - 2024**

DHE

**MIRATIMI I KUOTAVE TË PRANIMIT PËR STUDENTËT NË TË GJITHA CIKLET
E STUDIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023**

Në mbështetje të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3 pika 4/b, neni 4 pika 1, neni 23 pika 4, neni 25 pika 8, neni 38 pika 1/a dhe pika 3, neni 69 pika 3, neni 74 pika 2, neni 135 ; të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", neni 19 pika 3/ i dhe j, si dhe propozimeve të drejtuesëve të njësive kryesore me shkresat nr.03/1 prot, datë 12.01.2022 të FSHN-së, nr 05/1 prot, datë 14.01.2022 të FESHSH-së dhe nr. 05 prot, datë 14.01. 2022 të FE-së, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", në mbledhjen e tij të datës, 11.02. 2022,

V E N D O S I :

1. Të miratojë kriteret e pranimit për studentët në programet e ciklit të parë "Bachelor", për vitin akademik 2023 – 2024, si mëposhtë:
 - a. Nota mesatare e përgjithshme arithmetike e shkollës së mesme për të gjitha vitet përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore në masën 50 %.

- b. Nota mesatare e gruplëndëve bërthamë (për të gjitha vitet ku shtrihen lëndët), të përzgjedhura nga njësitë kryesore (fakultetet) për çdo program studimi të ciklit të parë në masën 50 % (sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij vendimi.)
2. Të miratojë kriteret e pranimiit për studentët në programet e studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” për vitin akademik 2023-2024 (sipas shtojcës 2) , si mëposhtë:
- a. Nota mesatare e studimeve të ciklit të parë të jetë ≥ 7 (shtatë)
3. Të miratojë kuotat e pranimiit për programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”, programeve me karakter profesional 2 – vjeçar, programeve të ciklit të dytë “Master” , “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” për vitin akademik 2022 – 2023 sipas shtojcës 3 bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK


Prof. dr Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 178 Prot.

Gjirokastrë, më 11/02/2022

V E N D I M

Nr. 04, datë 11/02/2022

**PËR PLANIN VJETOR TË VEPRIMTARIVE AKADEMIKE
DHE KËRKIMORE-SHKENCORE**

Në mbështetje të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 3; të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", neni 19 pika 3/1 si dhe vendimit të Rektoratit nr. 01, datë 10.02.2022 "Për planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore", Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej, në mbledhjen e tij të datës, 11.02.2022:

V E N D O S I :

1. Të miratojë planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore;
2. Plani i bashkëlidhet këtij vendimi;
3. Ky vendimi hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. dr. Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 192/1 Prot

Datë 16/02 2022

VENDIM

Nr. 05, datë 16.02.2022

PËR
MIRATIMIN E KËRKESËS PËR DORËHEQJE TË ZËVENDËS REKTORIT PËR
KËRKIMIN SHKENCOR DHE MARRËDHËNIET ME JASHTË

Në zbatim të nenit 39 pika 1 dhe nenit 40 pika 2 të ligjit 80/2015 " Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë nenet 30 dhe 31 dhe bazuar në kërkesën për dorëheqje të zëvendës rektorit për kërkimin shkencor dhe marrëdhëniet me jashtë, protokolluar me nr. 65, datë 12.01.2022, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 16.02.2022;

VENDOSI

1. Të miratoj kërkesën për dorëheqje të Prof.as.dr. Valbona Duri, Zv/Rektore për kërkimin shkencor dhe marrëdhëniet me jashtë;
2. Kërkesa e dorëheqjes, protokolluar me nr. 65, datë 12.01.2022 i bashkëlidhet këtij vendimi;
3. Ky vendi hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK


Prof.dr.Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 193 Prot

Datë 16/02 2022

VENDIM

Nr. 06, datë 16.02.2022

PËR
MIRATIMIN E ZËVENDËS REKTORIT PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE
MARRËDHËNIET ME JASHTË

Në zbatim të nenit 39 pika 1 dhe nenit 40 pika 2 të ligjit 80/2015 " Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër nenet 30 dhe 31 dhe bazuar në propozimin e Rektorit me shkresë nr.191, datë 2022, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej" në mbledhjen e tij të datës 16.02.2022

V E N D O S I

1. Të miratoj Kandidaturën e prof.as.dr. Merita Isaraj në pozicionin e Zëvendës Rektorit, për kërkimin shkencor dhe marrëdhëniet me jashtë;
2. Ky vendi hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK


Prof.dr.Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 194 Prot.

Gjirokastrë, më 16.02.2022

V E N D I M

Nr. 07, datë 16.02.2022

**PËR STRUKTURËN E PËRGJITHSHME TË UGJ-SË
DHE NUMURIN E PERSONELIT NË TË GJITHA NIVELET**

Në mbështetje të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 2/ç; të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", neni 19 pika 2/b dhe pika 3/f si dhe vendimit të Rektoratit nr.02 datë 10.02.2022 "Për strukturën e përgjithshme të UGJ-së dhe numrin e personelit në të gjitha nivelet", Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej, në mbledhjen e tij të datës, 16.02.2022;

V E N D O S I :

1. Të miratojë strukturën e përgjithshme të UGJ-së sipas *Aneksit 1* bashkëlidhur këtij vendimi;
2. Të miratojë numurin e personelit të UGJ-së në të gjitha nivelet sipas *Aneksit 2* bashkëlidhur këtij vendimi;
3. Vendimi me *Aneksin 2* i përcillet Bordit të Administrimit për të miratuar numurin e personelit të UGJ-së për të gjitha nivelet;
4. Ky vendimi hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. dr. Bektash MEMA



STRUKTURA E BRENDSHME AKADEMIKE DHE ADMINISTRATIVE E UGJ-SË 2022

Nr.	REKTORATI	FESHSH	FSHN	FE	Gjithsej		
1.	Rektor	-	-	-	1 (një)		
2.	Zv/Rektor	-	-	-	2 (dy)		
3.	Dekan	1 (një)	1 (një)	1 (një)	3 (tre)		
4.	Zv/Dekan	1 (një)	1 (një)	1 (një)	3 (tre)		
5.	Departamente	6 (gjashtë)	3 (tre)	3 (tre)	12 (dymbëdh.)		
6.	Grupe mësimore	2 (dy)	4 (katër)	-	6 (gjashtë)		
Gjithësej							
Sektorët							
7.	Drejtori 2 (dy)	a. Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakadematike Administrative	Sektori i shërbimeve juridike, personelit dhe sekretari-protokoll	Sektori i standarteve të cilësisë dhe korrikulave	Sektori i shërbimeve studentore dhe bibliotekare-arkivore	Sektori i kërkimit shkencor dhe marrëdhënjeve me jashtë	4 (katër)
			Sektorët				
			b. Drejtoria e Shërbimeve Universitare				
			Sektori i financë-prokurimeve	Sektori i shërbimeve			2 (dy)



NUMURI I PERSONELI TË UGJ-SË NË TË GJITHA NIVELET 2022

Nr.	FESHSH	FSHN	FE	REKTORATI	GJITHËSEJ
1.	Personel akademik	58 (pesëdhjetë e tetë)	32 (tridhjetë e dy)	24 (njëzetë e katër)	114 (njëqind e katërmëdhjetë)
2.	Pers. ndihmës akademik me karakter akademik	1 (një)	6 (gjashtë)	1 (një)	8 (tetë)
3.	Pers. ndihmës akademik me karakter administrativ	2 (dy)	2 (dy)	22 (njëzetë e dy)	28 (njëzetë e tetë)
4.	Personel administrativ	-	-	31 (tridhjetë e një)	31 (tridhjetë e një)
Gjithësej		61 (gjashtëdhjetë e një)	40 (dyzetë)	53 (dyzetë e dy)	181 (njëqind e tetëdhjetë e një)

Shënim:

- Në numurin e personelit akademik sipas njësive kryesore përfshihen edhe: rektori; zv/rektorët; dekanët dhe zv/dekanët;
- Në numurin e personelit administrativ përfshihet edhe administratori i UGJ-së





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr. 95 Prot.

Gjirokastrë, më 16.02 /2022

VENDIM

Nr. 08, datë 16.02 . 2022

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR FINANCIAR PËR VITIN 2021 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2022

Në zbatim të ligjit 80/2015 " Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 38, pika g dhe h, Statutit të universitetit "Eqrem Çabej", neni 19 pika 1/c dhe 1/f, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, në mbledhjen e tij të datës 16.02.2022;

VENDOSI

1. Të miratojë raportin vjetor financiar për vitin 2021.
2. Të miratojë detajimin e buxhetit për vitin 2022.
3. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK


Prof.dr.Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 358 Prot.

Gjirokastrë, më 23.03.2022

V E N D I M

Nr. 09, datë 23.03.2022

**MIRATIMI I FORMËS SË DIPLOMËS PËR PROGRAMIN E PËRBASHKËT ME
UNIVERSITETIN "ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË" DHE UNIVERSITETIN E
FIRENCES (ITALI),
MASTER EKZEKUTIV / MASTER I NIVELIT TË DYTË NË "RESTORATION,
CONSERVATION AND MANAGEMENT OF ARCHITECTURAL HERITAGE"**

Në mbështetje të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 91, dhe akteve nënligjore në fuqi, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", në mbledhjen e tij të datës, 23.03.2022;

V E N D O S I :

1. Të miratojë formën e diplomës për programin e përbashkët me universitetin "Zoja e Këshillit të Mirë" dhe Universitetin e Firences – Itali, Master Ekzekutiv / Master i Nivelit të Dytë në "Restoration, Conservation and Management of Architectural Heritage" program që realizohet me 60 kredite (ECTS), në 1 (një) vit akademik.
2. Formati i diplomës i bashkangjitet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. dr Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 362 Prot.

Gjirokastër, më 23/03/2022

V E N D I M

Nr. 10 , datë 23.03.2022

**PËR RIORGANIZMININ E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË
"MASTER PROFESIONAL" NË MËSUESI NDIHMËS NË EDUKIMIN
GJITHËPËRFSHIRËS**

NË

"MASTER" NË MËSUES NË ARSIMIN SPECIAL

Në zbatim të Ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë ", neni 35 pika 1, neni 38 pika dh, neni 83 pika 1/b, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, neni 63 pika 8, neni 68 pika 2, Akteve nënligjore në fuqi, Vendimit të Njesisë bazë , Nr.18, datë 17. 03. 2022 , Vendimit të Njesisë Kryesore FESHSH, Nr.03 , datë 18. 03. 2022, si dhe në mbështetje të shkresës së MAS, Nr. 1713 prot, datë 15.03.2022, me subjekt "Njoftim mbi vlerësimin e aplikimit" Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej , në mbledhjen e tij të datës, 23.03. 2022;

V E N D O S I;

1. Të miratojë ndryshimin emërtimit të programit të studimit mbështetur në rekomandimin e MAS nga *"Master" në Mësuesi Ndihmës në Edukimin Gjithëpërfshirës , në "Master" në Mësues në Arsimin Special , me 120 ECTS* i cili do të shtrihet në 2 (dy) vite akademike në sistemin me kohë të plotë .
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. dr Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr 363 Prot.

Gjirokastrë, më 23/03/2022

V E N D I M

Nr. 11 , datë 23.03.2022

MIRATIMI I DOKUMENTACIONIT PËR FAZËN E DYTË TË APLIKIMIT PËR
RIORGANIZMININ E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË "MASTER
PROFESIONAL" NË MËSUESI NDIHMËS NË EDUKIMIN GJITHËPËRFSHIRËS
NË
MASTER NË MËSUES NË ARSIMIN SPECIAL

Në zbatim të Ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë ", neni 35 pika 1, neni 38 pika dh, neni 83 pika 1/b. Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 63 pika 8, neni 68 pika 2, Akteve nënligjore në fuqi, Vendimit të Njesisë bazë , Nr. 19, datë 17. 03. 2022 , Vendimit të Njesisë Kryesore FESHSH, Nr.04 , datë 23. 03. 2022, si dhe në mbështetje të shkresës së MAS, Nr. 1713 prot, datë 15.03.2022, me subjekt "Njoftim mbi vlerësimin e aplikimit" Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej, në mbledhjen e tij të datës, 23. 03. 2022;

V E N D O S I ;

1. Të miratojë dokumentacionin e fazës së dytë të aplikimit për riorganizimin e programit të ciklit të dytë Master në "Mësues në Arsimin Special" me 120 kredite (ECTS).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i bashkëlidhet drafrit me dokumentacionin referuar udhezimit nr. 1, datë 14.01.2020, Kreu IV.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. dr Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 364 Prot.

Gjirokastrë, më 23/03/2022

V E N D I M

Nr. 12, datë 23.03.2022

**MIRATIMI I FORMËS SË DIPLOMËS PËR PROGRAMIN E CIKLIT TË DYTË
"MASTER " NË MËSUES NË ARSIMIN SPECIAL**

Në mbështetje të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 91, dhe akteve nënligjore në fuqi, vendim të Senatit Akademik nr.37, datë 23.11.2021 për "Riorganizimi i programit të studimit të ciklit të dytë "Master Profesional" në Mësuesi Ndihmës në Edukimin Gjithëpërfshirës" në "Master" në Mësues në Arsimin Special", Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", në mbledhjen e tij të datës, 23.03.2022;

V E N D O S I:

1. Të miratojë formatin e ri të diplomës në programin e ciklit të dytë "Master" në Mësues në Arsimin Special, program që realizohet me 120 kredite (ECTS) në 2 (dy) vite akademike.
2. Formatin e diplomës i bashkangjitet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. dr Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 365 Prot.

Gjirokastër, më. 23 / 03 / 2022

V E N D I M

Nr. 13 datë 23.03.2022

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Në mbështetje të nenit 38, pika 3 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 19 pika 3/c të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, në mbledhjen e tij të datës 23.03.2022,

V E N D O S I

Të miratojë:

1. Marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër dhe Universitetit "Polis", Tiranë.
2. Një kopje e marrëveshjes i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bekdash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr. 366 Prot.

Gjirokastrë, më. 23/03/2022

VENDIM

Nr. 14 datë 23.03.2022

PËR MARRËVESHJEN E BASHKËPUNIMIT MIDIS UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR DHE UNIVERSITETIT TË MAQEDONISË PERËNDIMORE

Në mbështetje të nenit 38, pika 3 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 19 pika 3/c të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, në mbledhjen e tij të datës 23.03.2022,

VENDOSI

Të miratojë:

1. Marrveshjen e bashkëpunimit midis Universitetit të Maqedonisë Perëndimore (Greqi) dhe Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.
2. Një kopje e marrëveshjes i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 650 Prot.

Gjirokastrë, më 03/06/2022

V E N D I M

Nr. 15, datë 03.06.2022

P Ë R

**MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT NË KUADËR TË REKOMANDIMEVE TË
LËNA NGA BORDI I AKREDITIMIT**

Në zbatim të Ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 19; Vendimit të Bordit të Akreditimit nr. 55, datë 16.12.2021 "Akreditimi periodik i institucionit të arsimit të lartë Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, si dhe referuar vendimit nr. 7 prot., datë 03.06.2022 të Rektoratit, si dhe vendimeve: nr. 3 prot., datë 02.06.2022 të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore; nr. 3 prot, datë 20.05.2022 të Fakultetit të Shkencave të Natyrës; nr. 3 prot, datë 02.06.2022 të Fakultetit Ekonomik, Senati Akademik në mbledhjen e datës 03.06.2022,

V E N D O S I;

1. Të miratojë miratojë planin e veprimit në përmbushje të rekomandimeve të lëna prej Bordit të Akreditimit për akreditimin periodik institucional sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Ky vendim i përcillet Agjensisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL)
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Njësitë Bazë, Njësitë Kryesore, Zv/ Rektori për procesin mësimor, Zv/ Rektori për marrëdhëniet me jashtë dhe kërkimin shkencor, si dhe Drejtoritë dhe Sektorët në Rektorat.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. dr Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 703 Prot

Datë 16.06 2022

VENDIM

Nr. 16, datë 16.06 2022

**PËR MIRATIMIN E "AKT-MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI" MIDIS
UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR DHE FAKULTETIT HISTORI-
FILOLOGJI TIRANË**

Bazuar nenin 38 pika 3 të Ligjit Nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; neni 19 pika 3/e të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej"; vendimin e Rektoratit nr 8 datë 16.06.2022, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 16.06.2022, diskutoi "Akt-Marrëveshje Bashkëpunimi" midis Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirrokastër dhe Fakultetit Histori-Filologji Tiranë me objekt "Organizimi i shkollës verore-Oral History" dhe

VENDOSI

1. Të miratojë marrëveshjen dhe vlerësimin buxhetor të realizimit, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi;
2. Vendimi, marrëveshja dhe vlerësimi buxhetor i përcillen Bordit të Administrimit për procedim të mëtejshëm;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK


Prof.dr.Bektash MEMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 783 Prot

Datë 07.07 2022

VENDIM

Nr. 17, datë 07.07 2022

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTIT "DYGJUHËSIA, MULTIKULTURA DHE INTEGRIMI"

Në mbështetje të nenit 110 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të vendimit nr. 75 datë 12.02.2012 "Për miratimin e modelit të financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor" të ndryshuar, të neneve 79 dhe 80 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë dhe në zbatim të urdhërit të MAS nr. 360 datë 28.06.2022 "Për shpalljen e thirrjes për financimin e IAL-ve publike, për projekte të përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, për vitin akademik 2022-2023" Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 07.07.2022, diskutoi për projektin "Dygjuhësia, multikultura dhe integrimi" dhe

VENDOSI

1. Të miratoj projektin "Dygjuhësia, multikultura dhe integrimi", i cili i bashkëlidhet këtij vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
3. Vendimi së bashku me projektin i përcillet Bordit të Administrimit për procedim të mëtejshëm si dhe MAS.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bektash MEMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 784 Prot

Datë 07/07 2022

VENDIM

Nr. 18, datë 07.07 2022

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT "APLIKIMI I METODAVE EVROPIANE NË
ZHVILLIMIN E PRAKTIKAVE PEDAGOGJIKE PËR STUDENTËT E MËSUESISË
NË DEGË TË NDRYSHME"**

1. Në mbështetje të nenit 110 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të vendimit nr. 75 datë 12.02.2012 "Për miratimin e modelit të financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor" të ndryshuar, të neneve 79 dhe 80 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë dhe në zbatim të urdhërit të MAS nr. 360 datë 28.06.2022 "Për shpalljen e thirrjes për financimin e IAL-ve publike, për projekte të përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, për vitin akademik 2022-2023" Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 07.07.2022, diskutoi për projektin "Aplikimi i metodave evropiane në zhvillimin e praktikave pedagogjike për studentët e mësuesisë në degë të ndryshme" dhe

VENDOSI

1. Të miratoj projektin "Aplikimi i metodave evropiane në zhvillimin e praktikave pedagogjike për studentët e mësuesisë në degë të ndryshme", i cili i bashkëlidhet këtij vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
3. Vendimi së bashku me projektin i përcillet Bordit të Administrimit për procedim të mëtejshëm si dhe MAS.

KRYETARI SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bektash MEMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 785 Prot

Datë 07/07 2022

VENDIM

Nr. 19, datë 07.07 2022

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT PËR NGRITJEN E LABORATORIT TË SIG-UT
SI DHE TË INFRASTRUKTURËS HAPSINORE, PRANË NJËSISË BAZË TË
HISTORISË, ANTROPOLOGJISË DHE GJEOGRAFISË**

Në mbështetje të nenit 110 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të vendimit nr. 75 datë 12.02.2012 "Për miratimin e modelit të financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor" të ndryshuar, të neneve 79 dhe 80 të Statutit të Universitetit "Eqrem Cabej" Gjirokastrë dhe në zbatim të urdhërit të MAS nr. 360 datë 28.06.2022 "Për shpalljen e thirrjes për financimin e IAL-ve publike, për projekte të përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, për vitin akademik 2022-2023" Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 07.07.2022, diskutoi për projektin "Ngritja e Labororit të SIG-ut si dhe i infrastrukturës hapsinore, pranë Njesisë Bazë të Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë" dhe

VENDOSI

1. Të miratoj projektin "Ngritja e Labororit të SIG-ut si dhe i infrastrukturës hapsinore, pranë Njesisë Bazë të Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë", i cili i bashkëlidhet këtij vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
3. Vendimi së bashku me projektin i përcillet Bordit të Administrimit për procedim të mëtejshëm si dhe MAS.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bektash MEMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 786 Prot

Datë 07/07 2022

VENDIM

Nr. 20, datë 07.07 2022

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT PROGRAMI I PËRBASHKËT MIDIS UNIVERSITETIT
TË GJIROKASTRËS (SHQIPËRI) DHE UNIVERSITETIT TË MAÇERATËS (ITALI),
NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE "MASTER I SHKENCAVE" NË ARKEOLOGJI,
HISTORI DHE ADMINISTRIM I PASURIVE KULTURORE-ASPIC**

Në mbështetje të nenit 110 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të vendimit nr. 75 datë 12.02.2012 "Për miratimin e modelit të financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor" të ndryshuar, të neneve 79 dhe 80 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë dhe në zbatim të urdhërit të MAS nr. 360 datë 28.06.2022 "Për shpalljen e thirrjes për financimin e IAL-ve publike, për projekte të përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, për vitin akademik 2022-2023" Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 07.07.2022, diskutoi për projektin Programi i përbashkët midis Universitetit të Gjirokastrës (Shqipëri) dhe Universitetit të Maçeratës (Itali), në Ciklin e dytë të studimeve "Master i shkencave" në Arkeologji, Histori dhe Administrim i pasurive kulturore-ASPIC dhe

VENDOSI

1. Të miratoj projektin Programi i përbashkët midis Universitetit të Gjirokastrës (Shqipëri) dhe Universitetit të Maçeratës (Itali), në Ciklin e dytë të studimeve "Master i shkencave" në Arkeologji, Histori dhe Administrim i pasurive kulturore-ASPIC, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
3. Vendimi së bashku me projektin i përcillet Bordit të Administrimit për procedim të mëtejshëm si dhe MAS.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bekdash MEMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 787 Prot

Datë 07.07 2022

VENDIM

Nr. 21, datë 07.07 2022

**PËR
MIRATIMIN E PROJEKTIT "DIXHITALIZIMI I INFRASTRUKTURËS SË MËSIMDHËNIES
NË UEÇGJ, 6 KLASA DIXHITALE"**

Në mbështetje të nenit 110 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të vendimit nr. 75 datë 12.02.2012 "Për miratimin e modelit të financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor" të ndryshuar, të neneve 79 dhe 80 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë dhe në zbatim të urdhërit të MAS nr. 360 datë 28.06.2022 "Për shpalljen e thirrjes për financimin e IAL-ve publike, për projekte të përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, për vitin akademik 2022-2023" Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 07.07.2022, diskutoi për projektin "Dixhitalizimi i infrastrukturës së mësimdhënies në UEÇGJ, 6 Klasa Dixhitale" dhe

VENDOSI

1. Të miratoj projektin "Dixhitalizimi i infrastrukturës së mësimdhënies në UEÇGJ, 6 Klasa Dixhitale", i cili i bashkëlidhet këtij vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
3. Vendimi së bashku me projektin i përcillet Bordit të Administrimit për procedim të mëtejshëm si dhe MAS.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bektash MEMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 788 Prot

Datë 07/07 2022

VENDIM

Nr. 22, datë 07/07 2022

PËR


**MIRATIMIN E PROJEKTIT "ZHVILLIMI I KAPACITETEVE AKADEMIKE NË
UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR, PJESË E IMPLEMENTIMIT
TË PROTOKOLLIT TË BASHKËPUNIMIT MIDIS UNIVERSITETIT TË
GJIROKASTRËS DHE UNIVERSITETIT TË JANINËS"**

Në mbështetje të nenit 110 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të vendimit nr. 75 datë 12.02.2012 "Për miratimin e modelit të financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor" të ndryshuar, të neneve 79 dhe 80 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë dhe në zbatim të urdhërit të MAS nr. 360 datë 28.06.2022 "Për shpalljen e thirrjes për financimin e IAL-ve publike, për projekte të përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, për vitin akademik 2022-2023" Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 07.07.2022, diskutoi për projektin "Zhvillimi i kapaciteteve akademike në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, pjesë e implementimit të protokollit të bashkëpunimit midis Universitetit të Gjirokastrës dhe Universitetit të Janinës" dhe

VENDOSI

1. Të miratoj projektin "Zhvillimi i kapaciteteve akademike në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, pjesë e implementimit të protokollit të bashkëpunimit midis Universitetit të Gjirokastrës dhe Universitetit të Janinës", i cili i bashkëlidhet këtij vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
3. Vendimi së bashku me projektin i përcillet Bordit të Administrimit për procedim të mëtejshëm si dhe MAS.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK


Prof.dr.Bekri MEMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 789 Prot

Datë 07/07 2022

VENDIM

Nr. 23, datë 07.07 2022

PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT "SUMMER SCHOOL" MIDIS UNIVERSITETIT TË GJIROKASTRËS DHE UNIVERSITETIT TË MAQEDONISË PERËNDIMORE, GREQI

Në mbështetje të nenit 110 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të vendimit nr. 75 datë 12.02.2012 "Për miratimin e modelit të financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor" të ndryshuar, të neneve 79 dhe 80 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë dhe në zbatim të urdhërit të MAS nr. 360 datë 28.06.2022 "Për shpalljen e thirrjes për financimin e IAL-ve publike, për projekte të përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, për vitin akademik 2022-2023" Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 07.07.2022, diskutoi për projektin "Projekt –propozim me titull "Summer School" midis Universitetit të Gjirokastrës dhe Universitetit të Maqedonisë Perëndimore, Greqi pranë Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore:

VENDOSI

Të miratojë projektin me titull "Summer School" midis Universitetit të Gjirokastrës dhe Universitetit të Maqedonisë Perëndimore, Greqi pranë Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi;

1. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
2. Vendimi së bashku me projektin i përcillet Bordit të Administrimit për procedim të mëtejshëm si dhe MAS.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. dr. Bektash MEMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 790 Prot

Datë 07/07 2022

VENDIM

Nr. 24, datë 07.07 2022

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT "SHKOLLA VERORE E TURIZMIT DHE
AGROTURIZMIT"**

Në mbështetje të nenit 110 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të vendimit nr. 75 datë 12.02.2012 "Për miratimin e modelit të financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor" të ndryshuar, të neneve 79 dhe 80 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë dhe në zbatim të urdhërit të MAS nr. 360 datë 28.06.2022 "Për shpalljen e thirrjes për financimin e IAL-ve publike, për projekte të përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, për vitin akademik 2022-2023" Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 07.07.2022, diskutoi për projektin "Shkolla verore e turizmit dhe agroturizmit" dhe

VENDOSI

1. Të miratojë projektin "Shkolla verore e turizmit dhe agroturizmit", i cili i bashkëlidhet këtij vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
3. Vendimi së bashku me projektin i përcillet Bordit të Administrimit për procedim të mëtejshëm si dhe MAS.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK


Prof.dr.Bektash MEMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 791 Prot

Datë 07.07 2022

VENDIM

Nr. 25, datë 07.07 2022

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT "DIXHITALIZIMI I LABORATORIT PËR
KRYERJEN E STUDY TOUR VIRTUAL 3- D NE TURIZEM"**

Në mbështetje të nenit 110 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të vendimit nr. 75 datë 12.02.2012 "Për miratimin e modelit të financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor" të ndryshuar, të neneve 79 dhe 80 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë dhe në zbatim të urdhërit të MAS nr. 360 datë 28.06.2022 "Për shpalljen e thirrjes për financimin e IAL-ve publike, për projekte të përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, për vitin akademik 2022-2023" Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 07.07.2022, diskutoi për projektin "Dixhitalizimi i laboratorit për kryerjen e study tour virtual 3- d ne turizem" pranë Fakultetit Ekonomik dhe

VENDOSI

1. Të miratojë projektin "Dixhitalizimi i laboratorit për kryerjen e study tour virtual 3- d ne turizem, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
3. Vendimi së bashku me projektin i përcillet Bordit të Administrimit për procedim të mëtejshëm si dhe MAS.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK


Prof.dr.Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 792 Prot

Datë 07/07 2022

VENDIM

Nr. 26, datë 07.07 2022

PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT "DIXHITALIZIMI I DY AUDITORËVE TË FESHSH-SË PËR TË DREJTUAR MËSIMDHËNIEN DREJT PERFEKSIONIT DHE DIXHITALIZIMIT"

Në mbështetje të nenit 110 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të vendimit nr. 75 datë 12.02.2012 "Për miratimin e modelit të financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor" të ndryshuar, të neneve 79 dhe 80 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë dhe në zbatim të urdhërit të MAS nr. 360 datë 28.06.2022 "Për shpalljen e thirrjes për financimin e IAL-ve publike, për projekte të përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, për vitin akademik 2022-2023" Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 07.07.2022, diskutoi për projektin me titull "Dixhitalizimi i dy auditorëve të FESHSH-së për të drejtuar mësimdhënien drejt perfeksionit dhe dixhitalizimit" pranë Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore:

VENDOSI

1. Të miratojë projektin me titull "Dixhitalizimi i dy auditorëve të FESHSH-së për të drejtuar mësimdhënien drejt perfeksionit dhe dixhitalizimit" i cili i bashkëlidhet këtij vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
3. Vendimi së bashku me projektin i përcillet Bordit të Administrimit për procedim të mëtejshëm si dhe MAS.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. dr. Bektash MBMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 782 Prot

Datë 07/07 2022

VENDIM

Nr. 27, datë 07/07 2022

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT "NDIKIMI I PERSONALITETIT DHE DISIPLINËS
POZITIVE NË ORJENTIMIN E KARIERËS TË NXËNËSIT, NË QARKUN E
GJIROKASTRËS"**

Në mbështetje të nenit 38 dhe 95 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të neneve 19 dhe 80 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; të nenit 8 të Rregullores të Universitetit "Eqrem Çabej", të vendimit të FESHSH nr. 6, datë 21.06.2022 për miratimin e projektit "Ndikimi i personalitetit dhe disiplinës pozitive në orjentimin e karrierës të nxënësit, në qarkun e Gjirokastrës", propozuar nga Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënjes, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 07.07.2022, diskutoi për projektin "Ndikimi i personalitetit dhe disiplinës pozitive në orjentimin e karrierës të nxënësit, në qarkun e Gjirokastrës" dhe

VENDOSI

1. Të miratoj projektin "Ndikimi i personalitetit dhe disiplinës pozitive në orjentimin e karrierës të nxënësit, në qarkun e Gjirokastrës", i cili i bashkëlidhet këtij vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
3. Vendimi së bashku me projektin i përcillet Bordit të Administrimit për procedim të mëtejshëm.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 901 Prot.

Gjirokastrë, më 09 / 08 / 2022

V E N D I M

Nr. 28, datë 09 . 08 . 2022

P Ë R

MIRATIMIN E PROJEKTBUXHETIT PËR VITIN 2023 DHE PROGRAMIN
BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025

Në zbatim të Ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pik 1/h; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 19, pika 2/c; Shkresën e MAS nr. 4692 Prot "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025"; Udhëzuesin nr. 4692/1 Prot "Për hartimin e buxhetit të Institucioneve të Arsimit të Lartë për periudhën afatmesme 2023-2025", Senati Akademik në mbledhjen e datës 09.08.2022, pasi u konsultua me draftin e paraqitur nga institucioni i administratorit, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, me shumicë votash

V E N D O S I;

1. Të miratoj projekt buxhetin për vitin 2023;
2. Të miratoj programin e buxhetit afatmesëm 2023-2025;
3. Vendimi i përcillet Bordit të Administrimit për miratim;
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. dr Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 955 Prot

Gjirokastrë, më 01/09/2022

VENDIM

Nr. 29, datë 01.09 2022

PËR

DISA AMENDIME TË RREGULLORES SË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ"

Në mbështetje të nenit 38, pika 1/d të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të nenit 19, pika 3/d të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej"; të propozimeve të: FESHSH nr. 61, datë 30.06.2022, FSHN nr. 45, datë 01.07.2022, FE nr. 45, datë 30.06.2022, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 01.09.2022, diskutoi për amendimin e neneve 78, 81, 83 të rregullores së Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë dhe

VENDOSI

Amendimin e neneve të sipërpërmendura si vijon:

1. Neni 78, pika 2: **Frekuentimi**, "Frekuentimi i seminareve, ushtrimeve, punëve praktike, punëve laboratorike dhe praktikave mësimore është i detyrueshëm në masën jo më pak se 80% të numrit të përgjithshëm të orëve", *të ndryshohet, si më poshtë vijon:*

"Frekuentimi i seminareve, ushtrimeve, punëve praktike, punëve laboratorike dhe praktikave mësimore është i detyrueshëm në masën jo më pak se 80% të numrit të përgjithshëm të orëve.

Në rast se lënda nuk përmban laboratore dhe/ose praktika mësimore dhe studenti ka frekuentuar lëndën në masën jo më pak se 80%, atëherë studenti nuk futet në provim në sezonin e radhës (të dimrit ose të verës). Studenti ka të drejtë të futet në provimin e lëndës përkatëse në sezonet pasardhëse".

Në rast se lënda përmban laboratore dhe/ose praktika mësimore dhe studenti ka frekuentuar lëndën në masën jo më pak se 50%, atëherë studenti nuk futet në provim në sezonin e radhës (të dimrit ose të verës). Studenti ka të drejtë të futet në provimin e lëndës përkatëse në sezonet pasardhëse me kushtin e plotësimit të diferencës së orëve të detyruara për frekuentim".

2. Neni 81, pika 1: **Organizimi i provimeve**, "Në përfundim të procesit mësimor, çdo pedagog që është përgjegjës lënde duhet t'u komunikojë studentëve në auditor:

-fitimin ose jo të së drejtës për t'u futur në provimin e lëndëve përkatëse;

-rezultatit e vlerësimit të vazhdueshëm në seminare, laboratore, tema e detyra kursi apo në forma të tjera të kontrollit të ushtruar gjatë semestrit, të specifikuara në syllabusin e hartuar nga pedagogu. Rezultati i vlerësimit të vazhdueshëm merret parasysh në të gjitha sezonet e provimeve”, *të ndryshohet, si më poshtë vijon:*

Në përfundim të procesit mësimor, çdo pedagog që është përgjegjës lënde duhet t’u komunikojë studentëve në auditor:

-fitimin ose jo të së drejtës për t’u futur në provimin e lëndëve përkatëse;

-rezultatit e vlerësimit të vazhdueshëm në seminare, laboratore, tema e detyra kursi apo në forma të tjera të kontrollit të ushtruar gjatë semestrit, të specifikuara në syllabusin e hartuar nga pedagogu. Rezultati i vlerësimit të vazhdueshëm, për të gjithë studentët që kanë frekuentuar merret parasysh në të gjitha sezonet e provimeve pasardhëse. Vlerësimi i vazhduar nuk penalizon studentin, për të marrë pjesë në sezonet pasardhëse.

3. Neni 83, pika 1: **Provimet me shkrim**, “Numri i pyetjeve (pyetje teorike ose ushtrime/problema llogaritëse) që përmban një tezë e provimit me shkrim varet nga vëllimi i lëndës, numri i leksioneve dhe i seminareve etj. Një tezë e provimit me shkrim përmban pyetje teorike dhe/ose ushtrime që vlerësohen në total me 80 pikë. Për çdo pyetje/ushtim vihen pikët përkatëse, në varësi të karakterit të pyetjes/ushtimit”, *të ndryshohet, si më poshtë vijon:*

“Numri i pyetjeve (teorike ose ushtrime/problema llogaritëse) që përmban një tezë me shkrim varet nga vëllimi i lëndës, numri i leksioneve dhe i seminareve etj. Një tezë e provimit përmban pyetje teorike dhe/ose ushtrime etj. që vlerësohen në total me 100 pikë, për çdo sezon provimi, ku 80 pikë janë nga provimi me shkrim dhe 20 pikë janë nga vlerësimi i vazhdueshëm. Për çdo pyetje/ushtim vihen pikët përkatëse, në varësi të karakterit të pyetjes/ushtimit”

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bektash MEHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr 963 Prot

Datë 02/09 2022

VENDIM

Nr. 30, datë 02.09 2022

PËR

**KRITERET E PRANIMIT TË KANDIDATËVE NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT
TË DYTË "MASTER", "MASTER PROFESIONAL", "MASTER I SHKENCAVE"**

Në mbështetje të nenit 38, pika 3 të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të nenit 19, pika 3/j të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej"; të nenit 51, pika 2 të rregullores së Universitetit "Eqrem Çabej"; të vendimit të dekanatit të FESHSH nr. 7, datë 29.07.2022 për "kriteret e pranimit të kandidatëve në programet e studimit të ciklit të dytë "Master", "Master Profesional", "Master i Shkencave"; të vendimit nr. 4, datë 29.07.2022 të FE për "kriteret e pranimit të kandidatëve në programet e studimit të ciklit të dytë "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave"; të propozimit të FSHN nr. 54, datë 01.09.2022 për kriteret e pranimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve "Master Profesional në Shkencat Infermierore", Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 02.09.2022, diskutoi për kriteret e pranimit të kandidatëve në programet e studimit të ciklit të dytë "Master", "Master Profesional", "Master i Shkencave" dhe

VENDOSI

1. Të miratoj kriteret e pranimit të kandidatëve në programet e studimit të ciklit të dytë "Master", "Master Profesional", "Master i Shkencave", të hartuara nga Njësitë Bazë të FESHSH, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi;
2. Të miratoj kriteret e pranimit të kandidatëve në programet e studimit të ciklit të dytë "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave", të hartuara nga Njësitë Bazë të FE, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi;
3. Të miratoj kriteret e pranimit të kandidatëve në programin e studimit të ciklit të dytë "Master Profesional në Shkencat Infermierore", të hartuara nga Njësia Bazë e Infermierisë, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 1410 Prot

Datë 08/11 2022

VENDIM

Nr. 31, datë 08.11 2022

**PËR PERSONELIN AKADEMIK ME ANGAZHIM ME KOHË TË PJESSHME DHE
PERSONELIN AKADEMIK TË FTUAR, ME KOHËZGJATJE TË CAKTUAR**

Bazuar nenin 40 pika 4 të ligjit Nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*"; nenin 19 pika 2/b të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej; shkresën nr. 93 të FESHSH; shkresën nr.79 të FSHN; shkresën nr. 93 të FE, vendimit të Rektoratit nr 12, datë 08.11.2022, Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 08.11.2022, diskutoj për personelin akademik me kohë të pjesshme dhe të ftuar, me kohëzgjatje të caktuar që do të angazhohet për vitin akademik 2022-2023 dhe

VENDOSI

1. Të miratoj personelin akademik të ftuar, sipas propozimeve të njësive kryesore dhe miratimit të Rektoratit, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi;
2. Të miratoj personelin akademik me kohë të pjesshme, sipas propozimeve të njësive kryesore dhe miratimit të Rektoratit, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
4. Vendimi i përcillet Bordit të Administrimit për procedim të mëtejshëm.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 14/11 Prot

Datë 08/11 2022

VENDIM

Nr. 32, datë 08/11 2022

PËR MIRATIMIN E MODULEVE NË KUADRIN E PROJEKTIT EntrAL

Bazuar nenin 40 pika 4 të ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; nenin 19 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej; vendimin e Rektoratit nr.11, datë 08.11.2022., Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 08.11.2022, diskutoi për akreditimin e moduleve të trainimit të stafit akademik dhe të studentëve të UGJ-së në kuadrin e projektit të BE EntrAL dhe

VENDOSI

1. Të miratoj akreditimin e modulit për trainimin e stafit akademik të UGJ-së, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi;
2. Qendra e të mësuarit gjatë gjithë jetës, LLL, të realizoj integrimin e këtyre moduleve;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bekdash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
SENATI AKADEMIK**

Nr 1412 Prot

Datë 08/11 2022

VENDIM

Nr. 33, datë 08.11 2022

PËR

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTRËS DHE QËNDRËS BALANCE TIRANË**

Në mbështetje të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 3; Statutit të Universitetit "Eqrem Cabej", neni 19; vendimit të Rektoratit nr., datë 08.11.2022, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej, në mbledhjen e tij të datës, 08.11. 2022 ;

VENDOSI:

1. Të miratoj marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrës dhe Qendra Balance Tiranë, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bektash MENA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr 1413 Prot

Datë 08/11 2022

VENDIM

Nr. 34, datë 08.11 2022

PËR KOHËZGJATJEN E STUDIMEVE

Në mbështetje të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 90; Statutit të Universitetit "Eqrem Cabej", neni 73; Rregullores së Universitetit "Eqrem Cabej", neni 64; Rregullores së Studimeve të Universitetit "Eqrem Cabej", neni 18; propozimin e FESHSH nr. 102, datë 07.11.2022; propozimin e FSHN nr. 113, datë 08.11.2022; propozimin e FE nr. 100, datë 08.11.2022; vendimin e Rektoratit nr. 09 datë 08.11.2022, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Cabej, në mbledhjen e tij të datës, 08.11. 2022 ;

VENDOSI:

1. Kategoria e studentëve, që kanë filluar studimet nga viti akademik 2016-2017 e në vazhdim dhe që janë paisur me numur matrikullimi, por kanë qënë pasivë, numurimi i periudhës së kohëzgjatjes së studimeve (dyfishi i kohëzgjatjes normale), të filloj prej vitit akademik kur studenti bëhet aktiv.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
3. Vendimi u përcillet njësive kryesore dhe bazë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bëktash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 1461 Prot

Datë 08 / 11 2022

VENDIM

Nr. 35, datë 08.11 2022

**PËR MIRATIMIN E FORMËS SË DIPLOMËS PËR PROGRAMIN E STUDIMIT TË
CIKLIT TË DYTË "MASTER I SHKENCAVE" NË FINANCË KONTABILITET**

Në mbështetje të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 91; Statutit të Universitetit "Eqrem Cabej", neni 19; udhëzimit nr. 14 datë 21.06.2022 " Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 10 datë, 30.03.2020, për përcaktimin e elementëve përbërës, formës së diplomës, ose certifikatës të lëshuar nga Institucionet e Arsimit të Lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor"; vendimit të Fakultetit Ekonomik nr. 09, datë 07.11.2022, vendimit të Rektoratit nr.10 datës 08.11.2022, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej, në mbledhjen e tij të datës, 08.11. 2022 ;

VENDOSI:

1. Të miratojë formën e diplomës për programin e studimit në ciklin e dytë "Master i Shkencave" në Financë Kontabilitet;
2. Vendimi i FE dhe formati i diplomës i bashkëlidhen këtij vendim;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bekdash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SENATI AKADEMIK**

Nr. 1415 Prot

Datë 08/11 2022

VENDIM

Nr. 36, datë 08.11 2022

**PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË QËNDRËS UNIVERSITARE NDËRDISIPLINORE
TË KËRKIMIT DHE ZHVILLIMIT**

Bazuar nenin 38 pika 3 të ligjit Nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*"; nenin 19 pika 3/d të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej, vendimin e Rektoratit nr. 14, datë 08.11.2022, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 08.11.2022, diskutoj projektstatutin e Qendrës Universitare Ndërdisciplinore të Kërkimit dhe Zhvillimit dhe

VENDOSI

1. Të miratoj draftstatutin e Qendrës Universitare Ndërdisciplinore të Kërkimit dhe Zhvillimit, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 1467 Prot

Datë 14/11 2022

VENDIM

Nr. 37, datë 14.11 2022

PËR MIRATIMIN E "STRATEGJISË PËR MBËSHTETJEN DHE PËRMIRËSIMIN E VAZHDUESHËM TË CILËSISË SË MËSIMDHËNIES DHE MËSIMNXËNIES NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË 2023-2028"

Në mbështetje të nenit Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të neneve 79 dhe 80 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 14.11.2022, diskutoi për "Strategjinë për mbështetjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në institucionet e arsimit të lartë 2023-2028" të hartuar në kuadër të implementimit të aktiviteteve të planifikuara për projektin TEKOMP - Strengthening Teaching Competences in Higher Education in Natural and Mathematical Sciences, me numër reference 598434-EPP-1-2018-1-RS-EPPKA2-CBHE-JP bashkëfinancuar nga fondet e BE dhe programit Erasmus+,

VENDOSI

1. Të miratojë "Strategjinë për mbështetjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në institucionet e arsimit të lartë 2023-2028";
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
3. Vendimi së bashku me strategjinë i përcillet Bordit të Administrimit për procedim të mëtejshëm.

NËN/KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. dr. Gëzim SALA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERISITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr. 1488 Prot.

Gjirokastrë, më 16.11.2022

V E N D I M

Nr. 38, datë 16.11.2022

PËR PLOTËSIMIN E VAKANCAVE NË KOMISIONIN INSTITUCIONAL TË
ZGJEDHJEVE (KIZ)

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015 "për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në republikën e shqipërisë" neni 131 si dhe rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastrë neni 6 pika 1, 1 /a, 3/c. Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 16.11.2022,

Vendosi:

1. Të shpallë hapjen e procesit të vetëkandidimit për plotësimin e vakancave për:

- a. Anëtar i Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ), përfaqësues i studentëve.
- b. Sekretarin e Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ).

Këtij vendimi i bashkëngjitet shpallja faktike me modalitetet dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikantët.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËN/KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Gëzim Sala





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr. 1489 Prot

Datë 16/11 2022

VENDIM

Nr. 39, datë 16.11.2022

**Për hapjen e programit të përbashkët, të ciklit të tretë të studimeve
"DOKTORATË" në: "Edukim"; "Teknologji" dhe "Shkenca shoqërore",
në bashkëpunim me Universitetin e Janinës (Greqi)**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 35 "Hapja, mbyllja dhe riorganizimi i programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë" pika 1, Neni 73 "Programet e ciklit të parë të studimeve", Neni 74 "Pranimi në ciklin e parë të studimeve", Neni 80 "Programet e përbashkëta të studimit"; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", neni 63, neni 65, neni 70, dhe Akteve nënligjore në fuqi; Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 16.11.2022,

VENDOSI:

1. Hapjen e programit të përbashkët, të ciklit të tretë të studimeve "DOKTORATË" në: "Edukim"; "Teknologji" dhe "Shkenca shoqërore", referuar nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, me kohë të plotë, pranë njësive bazë të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore si dhe institucioneve bashkëpunuese, Universitetit të Gjirokastrës (Shqipëri) dhe Universiteti të Janinës (Greqi), me zgjatje jo më pak se tre vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike.
2. Në përfundim të këtij programi të përbashkët, të studimeve të doktoratës, lëshohet diploma e përbashkët, e gradës shkencore "Doktor", nga Universiteti i Gjirokastrës (Shqipëri) dhe Universiteti i Janinës (Greqi), i ofruar në gjuhën shqip, greqisht dhe anglisht.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe një kopje e tij i kalon Bordit të Administrimit për miratim.

NËN/KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr. Gëzim SALA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 1490 Prot

Datë 16 / 11 2022

VENDIM

Nr. 40, datë 16 . 11 . 2022

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT
TË CIKLIT TË PARË BACHELOR "DIPLOMË E PËRBASHKËT" (DOUBLE
DEGREE PROGRAM) NË MENAXHIM DIGJITAL (DIGITAL MANAGEMENT): NË
BASHKËPUNIM ME UNIVERSITETIN E SALENTOS, ITALI**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë", Neni 35 "Hapja, mbyllja dhe riorganizimi i programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë" pikal, Neni 73 "Programet e ciklit të parë të studimeve", Neni 74 "Pranimi në ciklin e parë të studimeve", Neni 80 "Programet e përbashkëta të studimit"; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", neni 63, neni 65, neni 70, dhe Akteve nënligjore në fuqi;

Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 16.11.2022,

VENDOSI:

1. Hapjen e programit të ciklit të parë të studimeve (Diplomë e përbashkët) **Bachelor** në "Menaxhim Digjital", në bashkëpunim me Universitetin e Salentos, Itali, i cili realizohet në 3 (tre) vite akademike, me 180 ECTS, në sistemin me kohë të plotë, i ofruar nga Njësia Bazë e Administrimit Publik.
2. Në përfundim të këtij programi të ciklit të parë të studimeve (Diplomë e përbashkët) **Bachelor** në "Menaxhim Digjital", studenti do të marrë diplomë të përbashkët **Bachelor** në "Menaxhim Digjital".
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe një kopje e këtij vendimi i kalon Bordit të Administrimit për miratim.

NËN/KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Gëzim SALA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr. 1491 Prot

Datë 16 / 11 2022

VENDIM

Nr. 41, datë 16 . 11 .2022

**TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE BACHELOR "DIPLOMË E DYFISHTË"
(DOUBLE DEGREE PROGRAM) NË MENAXHIM I TURIZMIT TË QËNDRUESHËM
(SUSTAINABLE TOURISM MANAGEMENT): NË BASHKËPUNIM ME
UNIVERSITETIN E MOLISES, ITALI**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë", Neni 35 "Hapja, mbyllja dhe riorganizimi i programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë" pika 1, Neni 73 "Programet e ciklit të parë të studimeve", Neni 74 "Pranimi në ciklin e parë të studimeve", Neni 80 "Programet e përbashkëta të studimit"; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", neni 63, neni 65, neni 70, dhe Akteve nënligjore në fuqi;

Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 16.11.2022,

VENDOSI:

1. Hapjen e programit të ciklit të parë të studimeve (Diplomë e dyfishtë) Bachelor në "Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm", në bashkëpunim me Universitetin e Molises, Itali, i cili realizohet në 3 (tre) vite akademike, me 180 ECTS, në sistemin me kohë të plotë, i ofruar nga Njësia Bazë e Politikave Ekonomike dhe Turizmit.
2. Në përfundim të këtij programi të ciklit të parë të studimeve (Diplomë e dyfishtë) Bachelor në "Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm", studenti do të marrë diplomë të dyfishtë "Bachelor në "Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm".
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe një kopje e këtij vendimi i kalon Bordit të Administrimit për miratim.

NËN/KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Gëzim SALA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 1555 Prot.

Gjirokastrë, më 23 / 11 / 2022

V E N D I M

Nr. 42, datë 23. 11. 2022

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE
"BACHELOR" NË MËSUESI PËR EDUKIMIN FIZIK E SPORT**

Në zbatim të Ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 35 pika 1, neni 38 pika dh, neni 80 pika 1, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 63 pika 8, neni 65, neni 70, VKM-së Nr. 185 datë, 25.03.2021, për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 18.12.2018, të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" dhe Udhëzimit Nr.1, datë 14.01.2020 për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë" Kreu IV/A "Dokumentacioni dhe procedura për hapjen e programeve të studimit", Vendimit të Njesisë bazë, Nr. 22, datë 18.11.2022, Vendimit të Njesisë Kryesore FESHSH, Nr. 12, datë 21. 11. 2021, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", në mbledhjen e tij të datës, 23.11 2022;

V E N D O S I;

1. Të miratojë hapjen e programit të përbashkët në ciklin të parë "Bachelor" në Mësuesi për Edukim Fizik e Sport, me 180 ECTS, i shtrirë në 3 (tre) vite akademike në sistemin me kohë të plotë, në bashkëpunim me Universitetin Barleti - Tiranë.
2. Ky program studimi do të ofrohet nga Njësia bazë e Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies, në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore UGJ dhe Njësia bazë e Edukimit Fizik dhe Sportit pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit në Universitetin Barleti - Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.

NËN/KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. dr Gëzim SALA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 1561 Prot.

Gjirokastrë, më 23.11/2022

V E N D I M

Nr. 43, datë 23.11.2022

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT ME UNIVERSITETIN E
MACERATES - ITALI DHE UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR,
"MASTER I SHKENCAVE" NË ARKEOLOGJI, HISTORI DHE ADMINISTRIM I PASURIVE
KULTURORE- ASPIC**

Në zbatim të Ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 35 pika 1, neni 38 pika dh, neni 77, neni 80 pika 1, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 63 pika 8, neni 69, neni 70, dhe aktet nënligjore në fuqi, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", në mbledhjen e tij të datës, 23.11.2022, diskutoi për programin e përbashkët Master i Shkencave" në Arkeologji, histori dhe administrim i pasurive kulturore - ASPIC dhe në mënyre unanime;

V E N D O S I;

1. Të miratojë hapjen e programit të përbashkët, Master i Shkencave" në Arkeologji, histori dhe administrim i pasurive kulturore – ASPIC, në bashkëpunim me Universitetin e Maceratës – Itali.
2. Kjo diplomë do të jetë me titull të dyfishtë "Master i Shkencave në Histori dhe Arkeologji për Inovacion" i universitetit të Maceratës dhe "Master i Shkencave në Arkeologji, Histori dhe Administrim i Pasurive Kulturore- " i universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Bordit të Administrimit të Universitetit.

NËN / KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. dr Gëzim SALA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr 1562 Prot

Data 23 / 11 2022

Nr. 44, datë 23.11 . 2022

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SPECIFIKE PËR REALIZIMIN E
PROGRAMIT NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE "BACHELOR" (DIPLOMË E
DYFISHTË) NË "MENAXHIM I TURIZMIT TË QËNDRUESHËM" NË
BASHKËPUNIM ME UNIVERSITETIN E MOLISES, ITALI**

Në zbatim të Ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, neni 80, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 7, neni 70, Rregullores së brendshme të UGJ-së, neni 43 dhe Udhëzimit Nr.1, datë 14.01.2020 për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë " Kreu IV/A "Dokumentacioni dhe procedura për hapjen e programeve të studimit", pika 6, Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës, 23. 11. 2022;

VENDOSI;

1. Të miratojë marrëveshjen specifike për realizimin e programit (diplomë e dyfishtë), në ciklin e parë të studimeve "Bachelor" në "Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm" i cili do të realizohet në bashkëpunim me Universitetin e Molisës, Itali.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe një kopje e këtij vendimi i kalon Bordit të Administrimit për miratim.

NËN/KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Gëzim SALA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 1563 Prot

Data 23 / 11 2022

V E N D I M

Nr. 45, datë 23.11 .2022

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SPECIFIKE PËR REALIZIMIN E
PROGRAMIT TË PËRBASHKËT NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE
"BACHELOR" NË "MENAXHIM DIGJITAL" NË BASHKËPUNIM ME
UNIVERSITETIN E SALENTOS, ITALI

Në zbatim të Ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë ", neni 3, neni 80 , Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 7, neni 70, Rregullores së brendshme të UGJ-së, neni 43 dhe Udhëzimit Nr.1, datë 14.01.2020 për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë " Kreu IV/A "Dokumentacioni dhe procedura për hapjen e programeve të studimit", pika 6 , Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës, 23. 11. 2022;

V E N D O S I;

3. Të miratojë marrëveshjen specifike për realizimin e programit të përbashkët, në ciklin e parë të studimeve "Bachelor" në "Menaxhim Digjital" i cili do të realizohet në bashkëpunim me Universitetin e Salentos, Itali.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe një kopje e këtij vendimi i kalon Senatit Akademik për miratim.

NËN/KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Gëzim SALA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 1585 Prot.

Gjirokastrë, më 25.11/2022

VENDIM

Nr. 46, datë 25.11.2022

PËR PLOTËSIMIN E VAKANCAVE NË KOMISIONIN INSTITUCIONAL TË
ZGJEDHJEVE (KIZ)

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015 "për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në republikën e shqipërisë" neni 131 si dhe rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastrë neni 6 pika 1, 1 /a, 3/c., Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 25.11.2022, zgjodhi anëtarët e Komisionit Institucional të Zgjedhjeve me votim të fshehtë. Me shumicën e thjeshtë të anëtarësisë së tij nga 12 (dymëdhjetë) persona të pranishëm me 12 (dymëdhjetë) vota pro, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Të zgjedhë:

1. Anëtar i Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ), përfaqësues i studentëve
Z. Andi Ruçi
2. Sekretar i Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ).
Znj. Vjollca Rrapai

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËN/KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Gëzim Sala



VENDOSI

1. Të miratojë hapjen e atyre programeve të studimit të cilat kanë një numër minimal prej 10 studentë të regjistruar për vitin akademik 2022 – 2023, të cilëve u shtohet edhe numri i studentëve sipas kategorive si mëposhtë:
 - Të transferuar
 - Me program të dytë studimi
 - Përsëritës në vitin e parë
2. Bashkangjitur këtij vendimi gjendet dhe tabela përmbledhëse për vitet e para në të gjitha programet e studimit për të dyja ciklet e studimit që ofron UGj-ja ;
3. Të shpall joaktiv për vitin akademik 2021-2022 për shkak të mosregjistrimeve këto programe studimi:
 - a. Bachelor në histori dhe gjuhë italiane;
 - b. Bachelor në matematikë-informatikë;
 - c. Master në AMU në matematikë-fizikë;
 - d. Master në AMU në gjuhë, letërsi dhe qytetërim grek;
 - e. Master në AMU në gjuhë dhe qytetërim Italian.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Bordit të Administrimit të Universitetit “Eqrem Çabej”.

NËN/KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Gëzim SALA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr 1606 Prot

Datë 02/12 2022

VENDIM

Nr. 47, datë 02.12.2022

PËR

**REGJISTRIMET E STUDENTËVE NË UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ" PËR
VITIN AKADEMIK 2022-2023**

Në zbatim të ligjit 80/2015 " Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" nenet: 72, 74 dhe 76; të statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, nenet: 64,65,66; udhëzimit nr 16, datë 29.06.2022 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr.10, datë 15.05.2019 "Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë.* Senati Akademik, pasi mori në analizë vendimin e Rektoratit nr.15, datë 30.11.2022, në mbledhjen e tij të datës 02.12.2022 diskutoi rreth regjistrimeve të reja në programet e studimit të ciklit të parë, ciklit të dytë dhe programeve profesionale që Universiteti "Eqrem Çabej" ofron për vitin akademik 2022 - 2023, pas përmbylljes të regjistrimeve në zbatim të udhëzimit të sipërcituar.

Pas diskutimeve për një numër të ulët të studentëve të regjistruar në programet e studimit në fushën e mësuesisë , e cila vjen si pasojë e rritjes së kriterit të notës mesatare në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 46, datë 27.01.2021 "*Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimit në fushën e mësuesisë për programet e ciklit të parë dhe programet e integruara të ciklit të dytë osë të transferimit të studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve , në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej",



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK**

Nr. 1742 Prot.

Gjirokastrë, më 23 / 12 /2022

VENDIM

Nr. 48, datë 23 . 12 . 2022

PËR

**MIRATIMIN E RAPORTIT TË DETAJUAR VJETOR TË VEPRIMTARISË
MËSIMORE, SHKENCORE DHE FINANCIARE NË UNIVERSITETIN "EQREM
ÇABEJ" PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022**

Në zbatim të Ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 1 gwrmat "g" dhe "l"; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 19, pika 2/e dhe pika 8; udhëzimit të MAS nr. 5, datë 19.02.2018, "Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatet për raportim të institucioneve të arsimit të lartë", ndryshuar me udhëzimin nr. 24, datë 21.10.2019, mbledhja e përbashkët e Senatit Akademik dhe e Bordit të Administrimit, datë 23.12.2022, pasi diskutoji mbi projektraportin e hartuar nga Rektorati, përcjellë me shkresë nr.1740, datë 23.12.2022,

VENDOSI;

1. Të miratoj raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë mësimore, shkencore dhe financiare të UGJ-së për vitin akademik 2021-2022;
2. Raporti i bashkëlidhet këtij vendimi;
3. Raporti vjetor për veprimtarinë mësimore, shkencore dhe financiare në Universitetin "Eqrem Çabej" për vitin akademik 2021-2022, i përcillet zyrtarisht MAS-it në format elektronik (PDF) dhe shkresor;
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. dr Bektash MEMA

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Prof.as.dr. Merita ISARAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 1743 Prot

Datë 23/12 2022

VENDIM

Nr. 49, datë 23.12 2022

PËR

**MARRËVESHJEN E BASHKËPUNIMIT MIDIS UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR DHE INSTITUTIT ITALIAN TË KULTURËS, TIRANË**

Bazuar nenin 38, pika 3 të Ligjit Nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*"; nenit 19, pika 3/e të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", Senati Akademik pasi diskutoji mbi propozimin e Rektoratit nr.1741, datë 23.12.2022 me objekt lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit me Institutin Italian të Kulturës Tiranë,

VENDOSI

1. Të miratoj marrëveshjen e bashkëpunimit midis Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë dhe Institutit të Kulturës Italiane Tiranë, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
3. Marrëveshja pas protokollimit i përcillet sektorit të kërkimit shkencor dhe marrëdhënjëve me jashtë;

KRYETARI SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bektash MEMA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
SENATI AKADEMIK**

Nr 1744 Prot

Datë 23/12 2022

VENDIM

Nr. 50, datë 23. 12 2022

PËR

**MARRËVESHJEN E BASHKËPUNIT MIDIS UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR DHE UNIVERSITETIT TË JANINËS (GREQI) PËR STUDIMET
DOKTORALE**

Bazuar nenin 38, pika 3 të Ligjit Nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*"; nenit 19, pika 3/e të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", Senati Akademik pasi diskutoj mbi propozimin e Rektoratit nr.1741, datë 23.12.2022, me objekt lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit me Universitetin e Janinës (Greqi) për studimet doktorale,

V E N D O S I

1. Të miratoj marrëveshjen e bashkëpunimit për studimet doktorale midis Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër dhe Universitetit të Janinës (Greqi), e cila i bashkëlidhet këtj vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
3. Marrëveshja pas protokollimit i përcillet Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore dhe Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë;

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr. 1745 Prot.

Gjirokastrë, më 23/12/2022

V E N D I M

Nr. 51, datë 23.12.2022

P Ë R

FORMAT E VLERËSIMIT NË SISTEMIN SHQIPTAR DHE EUROPIAN

Në zbatim të Ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 3; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 18 pika 6 dhe pika 4.4 e shtojcës së Statutit/Suplementi i Diplomës; Rregullores së Univrsitetit "Eqrem Çabej", neni 89 pika 1, Senati Akademik pasi mori në analizë vendimin e Rektoratit nr 16, datë 20.12.2022 "Për format e vlerësimit në sistemin shqiptar dhe europian", me objektiv për të konvertuar vlerësimet e hapësirës europiane të arsimit të lartë në sistemin shqiptar të vlerësimit,

V E N D O S I

1. Të miratoj modelin e formës së vlerësimit në sistemin shqiptar dhe europian, sipas Aneksit, bashkëlidhur këtij vendimi;
2. Vendimi së bashku me Aneksin, u përcillet njësive kryesore dhe njësive bazë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. dr Bektash MEMA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SENATI AKADEMIK**

Nr 1746 Prot

Datë 23/12 2022

VENDIM

Nr. 52, datë 23.12 2022

PËR

**MARRËVESHJEN E BASHKËPUNIT MIDIS UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR DHE WESTERN MICHIGAN UNIVERSITY**

Bazuar nenin 38, pika 3 të Ligjit Nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*"; nenit 19, pika 3/e të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", Senati Akademik pasi diskutoji mbi propozimin e Rektoratit nr.1741, datë 23.12.2022, me objekt lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit me Western Michigan University,

VENDOSI

1. Të miratoj marrëveshjen e bashkëpunimit midis Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë dhe Western Michigan University, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
3. Marrëveshja pas protokollimit i përcillet sektorit të kërkimit shkencor dhe marrëdhënieve me jashtë;

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bektash MEMA



4. Vendimi së bashku me projektin i përcillet Bordit të Administrimit për procedim të mëtejshëm si dhe MAS;
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bekdash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr. 1744 Prot

Datë 23/12 2022

VENDIM

Nr. 53, datë 23.12 2022

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT, TË CIKLIT TË TRETË TË
STUDIMEVE "DOKTORATURË" NË: "EDUKIM" DHE "SHKENCA SHOQËRORE",
NË BASHKËPUNIM ME UNIVERSITETIN E JANINËS (GREQI)**

Në mbështetje të Ligjit nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenet: 38 pika 1/dh, neni 77 pika 1 dhe 4 dhe 78, 79, 80 dhe 88; të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 19 pika 3/h dhe nenet 69, 70 dhe 75, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 23.12.2022, diskutoi mbi draftpropozimin e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, i vendimuar nga Dekanati i këtij fakulteti me nr. 11, datë 14.11.2022, me objekt hapja e programit të përbashkët të ciklit të tretë "Doktoraturë" me Universitetin e Janinës (Greqi), në "Edukim" dhe "Shkenca Shoqërore" dhe

VENDOSI

1. Të miratoj hapjen e programit të përbashkët të ciklit të tretë "Doktoraturë" në "Edukim" dhe "Shkenca Shoqërore", me kohë të plotë, pranë Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore;
2. Realimin e programit të përbashkët nga: Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë dhe Fakulteti i Edukimit në Universitetin e Janinës (Greqi);
3. Një kopje e draftit depozitohet pranë Sektorit të Standareve të Cilësisë dhe Korrikulave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 1761 Prot.

Gjirokastrë, më 30 / 12 / 2022

V E N D I M

Nr. 54, datë 23.12.2022

**PËR PLANIN VJETOR TË VEPRIMTARIVE AKADEMIKE
DHE KËRKIMORE-SHKENCORE**

Në mbështetje të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 3; të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", neni 19 pika 3/1 si dhe vendimeve të fakulteteve: FESHSH vendimi Nr. 13, datë 15.12.2022, FE vendimi Nr.15, datë 15.12.2022, FSHN vendimi Nr. 07, datë 19.12.2022. "Për planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore", Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej, në mbledhjen e tij të datës, 23.12.2022:

V E N D O S I :

1. Të miratojë planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore;
2. Plani i bashkëlidhet këtij vendimi;
3. Ky vendimi hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. dr. Bektash MUSA

